# DËSHMI ARKIVI

**A-470674**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Mashtruesit grabisin 95 milionë euro nga Intesa Sanpaolo përmes AI |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394223.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 07:07:05 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 26 shtator 2026, 06:55:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 26 shtator 2026, 06:54:00 UTC → 26 shtator 2026, 06:56:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0eb9fc8a2b796ffd266164ed2773612f483417249f1713b9e2cc1e7b84b07efd` |
| TEKSTI | `05c8f747b2c200fce1c9ee0eb58e365f35d919d9ea836add1b62275f0e8776af` |
| PAMJA | `137ef6c601a63d9637bb05fbee4fb290d510b8d09197a592d556490492fc1c4d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `178073adc497e57ba8b28668a00ac41678f34565706c287a8c844ee8e5128fd8` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a38a4fa799b1e73bbabeaa0ef113694411dbd892b18eb619eb2f3db166512539` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/178073adc497e57ba8b28668a00ac41678f34565706c287a8c844ee8e5128fd8`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Mashtruesit grabisin 95 milionë euro nga Intesa Sanpaolo përmes AI

Shkruar nga: S. H | Publikuar më: 26.09.2026, 08:55



Mashtruesit grabisin 95 milionë euro nga Intesa Sanpaolo përmes AI

Një mashtrim financiar me përdorimin e inteligjencës artificiale ka goditur bankën private italiane Fideuram, pjesë e grupit Intesa Sanpaolo, duke shkaktuar një humbje prej rreth 95 milionë eurosh. Sipas Reuters, mbi gjysmën e shumës është rikuperuar, ndërsa rreth 36 milionë euro mbeten ende të pakthyera. Skema nisi në shkurt, kur ish-presidenti i Fideuram, Paolo Molesini, mori në WhatsApp një mesazh që dukej se vinte nga CEO i Intesa Sanpaolo, Carlo Messina, me kërkesën për një transaksion urgjent jashtë vendit.

Mashtruesit e përforcuan skemën përmes një telefonate të rreme nga një drejtues i një studioje të njohur ligjore. Sipas burimeve të cituara nga Reuters, zëri i avokatit ishte klonuar me anë të inteligjencës artificiale. Duke besuar se udhëzimi ishte autentik, Molesini autorizoi një seri transfertash drejt llogarive jashtë Italisë, kryesisht në Kinë dhe Hong Kong. Pas zbulimit të mashtrimit, autoritetet italiane bashkëpunuan me ato kineze dhe portugeze dhe arritën të rikuperonin rreth 53 milionë euro.

Pjesa tjetër e parave dyshohet se është transferuar përmes një rrjeti llogarish jashtë vendit dhe më pas është konvertuar në kriptomonedha. Molesini dhe drejtues të tjerë të Fideuram nuk janë nën hetim, ndërsa Prokuroria e Milanos ka vënë nën hetim një shtetas të huaj që jeton jashtë Europës. Rasti tregon një nga mënyrat gjithnjë e më të sofistikuara me të cilat inteligjenca artificiale po përdoret për imitimin e zërave dhe identiteteve të drejtuesve, me synim realizimin e transfertave të mëdha financiare.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

ARTIKULL JOETIK?

## TË NGJASHME

## Më të fundit

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.